

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16 TETOR 2003**

**PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 16. 10. 2003. GODINE**

TETOR - OKTOBAR
2003

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 TETOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Bashkëkryesues Oliver Ivanoviq, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë mendoj se mund të fillojmë.

Mirëmëngjes dhe mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare.

Materialet iu janë shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve.

Rendi i ditës është miratuar në seancën e kaluar plenare. Andaj, shpresoj se janë plotësuar të gjitha kushtet për të filluar me shqyrtimin e rendit të ditës.

Pikë e parë është:

- Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Mendoj se kemi një praktikë të mirë që, ata që kanë ndonjë sygjerim, për lëshime eventuale ose jokorrektësi në Procesverbal, ta bëjnë atë me shkrim.

Ju falemnderit për mirëkuptim.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pesticidet.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për pesticidet, ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për pesticidet dhe amendamentet e propozuara, nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për pesticidet dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimet e komisioneve parlamentare.

Prandaj, vazhdojmë me amendamente:

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

(Flitet prej vendi, nuk dëgjohet qartë)

Nuk na lejon Rregullorja e punës.

Kush është për këtë amendament, i lutem të çojë dorën. Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Konsideroj se u aprovua amendamenti 1.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër?

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni funksional, i përkraur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon kush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon kush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A abstenon kush? Nuk abstenon.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Dhe, amendamenti i fundit 21, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Një abstenim.

Kalon amendamenti.

Dhe, tani do t'ju lus që ta votojmë Ligjin, e amendamentuar, në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka asnjë abstenim. Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

Është ligj i parë, po më duket, që ua miratua... Nëse s'është, atëherë po korrigjohem. Qenka, jo i pari.

94 deputetë janë të pranishëm.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi – All.

Vazhdojmë me pikën vijuese të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sportin.

Mirëseardhje i dëshiroj ministrit Behxhet Brajshori. Foltorja është e juaja, zoti ministër.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës - profesor Daci, të nderuar deputetë,

Keni para jush propozimligjin e sportit të Kosovës. Më lejoni që me rastin e paraqitjes së ekspozesë së shkurtër në lidhje me të, të tërheq vëmendjen tuaj në rrethanat që shtruan nevojën për hartimin e tij, si dhe në efektet që priten të arrihen me zbatimin e tij.

Hartimi i propozimligjit të sportit, është rezultat i punës ekipore të ekspertëve vendës, i konsultimit të dokumenteve ndërkombëtare të sportit dhe i legjislacionit të një numri të konsiderueshëm të vendeve të Evropës, si dhe i vjeljes së këshillave dhe sygjërimeve nga përfaqësues – ekspertë të Këshillit të Evropës.

Është ky një rast i mirë falënderimi për të gjithë ata që ndihmuan në hartimin e këtij dokumenti.

Propozimligjin e sportit po e diskutojmë në kohën e të arriturave në sportin e Kosovës, por edhe të shfaqjes së disa dukurive negative në të.

Ndonëse në kushte relativisht të vështirësuar, për shkak të gjendjes së përgjithshme në Kosovë, sportistët tanë arritën që të sensibilizojnë mundësitë e tyre për t'u ballafaquar me rezultatet e sportistëve kulminant. Mirëpo, statusi ende i panjohur i Kosovës, po shërben si një digë që sportistët tanë të shtrijnë veprimtarinë dhe talentin e tyre në arenat e sportit ndërkombëtar.

Megjithkëtë, sporti ynë nuk është imun nga disa dukuri negative. Dhuna në të është e pranishme dhe po bëjmë përpjekje që përmasat e saj t'i zvogëlojmë.

Shpresojmë se infrastruktura juridike do të jetë një faktor shumë i rëndësishëm në tejkalimin e gjendjes së krijuar, edhe pse nuk duhet krijuar iluzione se vetë ajo do t'mund t'i parandalojë dukuritë negative dhe po qe se e gjithë shoqëria e veçanërisht klubet dhe federatat sportive nuk angazhohen më shumë dhe nuk marrin përgjegjësi më të madhe.

Në fakt, qëllimi i ligjit do të jetë përcaktimi i përgjegjësive të bartësve të veprimtarisë sportive, rreth menaxhimit me të, në radhë të parë, si dhe ofrimi i një kornize për organizimin, kushtet dhe mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë sportive, si dhe për të drejtat dhe detyrat e organizatave sportive në lidhje me to.

Së këndejmi, propozimligji përcakton parimet themelore të ushtrimit të veprimtarisë sportive si veprimtari të interesit publik dhe mbështetjen institucionale të saj, por njëkohësisht përmbanë dispozita ndëshkimore për shkeljet e detyrimeve nga ana e organizatave sportive ose për mospërbushjen e përgjegjësive që burojnë nga to.

Propozimligji i sportit, promovon të drejtën për të gjithë për marrjen me veprimtari sportive, duke përcaktuar karakterin e saj dhe parimet e vullnetarizmit dhe profesionalizmit, si dy kahje kryesore të ushtrimit të saj.

Me interes të qartësimit të koncepteve, rëndësi e veçantë i është kushtuar përkufizimeve themelore të nocioneve dhe këto përkufizime janë bërë në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të sportit. Ndërsa, qëllimet dhe synimet e sportit fokusohen në nxitjen dhe zhvillimin e

sportit për të gjithë dhe institucionalizimin e tij sipas përvojave evropiane dhe më gjerë.

Kështu, klubet dhe federatat e sporteve, janë përkufizuar sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare me anë të të cilave do të zhvillojnë aktivitetet e tyre. Ndërsa, Komiteti Olimpik i Kosovës është trajtuar si organizatë më e lartë sportive joqeveritare.

Në propozimligjin e sportit, një vëmendje e veçantë i kushtohet të gjithë pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe veçanërisht kategorizimit të tyre, si dhe procedurave dhe kritereve që duhet të kihen parasysh në lidhje me këtë.

Marrëdhëniet sportive me jashtë, përbëjnë fushë të veçantë të rregullimit ligjor, po sikur edhe raporti i organeve përgjegjëse për sportin në organizatat sportive. Që të dyja këto, janë vënë nën mbikëqyrjen e Ministrisë në rast të parregullsive në punë ose shkeljeve të parimeve që i përcakton ajo për veprimin e organizatave sportive.

Për shkak të peshës dhe rëndësisë që kanë për zhvillimin, masovitetin dhe ngritjes së cilësisë në sport, edukimi fizik dhe sporti në shkolla dhe në universitete përbën një kapitull të veçantë të propozimligjit. Me këtë përcaktim, krijohet hapësirë për përfshirjen më të gjerë të nxënësve dhe studentëve në këto veprimtari.

Fusha të tjera të veçanta që janë trajtuar në propozimligjin e sportit, janë: mbrojtja shëndetësore dhe financimi i sportit, përfshirë edhe mundësitë e reklamave dhe të sponsorimit të sportit.

Kapitulli mbi luftimin e dhunës në sport, është nën ndikimin e dukurive negative që po shfaqen në ndeshjet sportive dhe nevojat e ndëshkimit adekuat të tyre.

Deputetë të nderuar,

Propozimligji ka marrë parasysh numrin më të madh të sygjerimeve në seminare me ekspertët e Këshillit të Evropës dhe të propozimeve nga debati publik. Në këtë mënyrë, ai i është përshtatur parimeve dhe

standardeve ndërkombëtare të sportit, por edhe kërkesave të klubeve dhe federatave sportive për një autonomi më të madhe të tyre.

Ministria është e ndërgjegjshme për mangësitë e propozimligjit, si pasojë e moskompletimit në fushën e privatizimit. Prandaj, në propozimligjin e sportit ka norma që përmbajnë vetëm parime, me shpresë që, me kalimin e kohës, të shndërrohen në zgjidhje konkrete, me plotësime dhe ndryshime të tij.

Megjithkëtë, ky propozimligj përmban kornizën e domosdoshme ligjore, në bazë të së cilës do të arrihet mirëvajtja dhe avancimi i veprimtarisë sportive dhe vendosja e rendit dhe rregullit në të.

Rregullimi i shum fushave me rëndësi për sportin dhe zhvillimin e tij do të shërbejë si bazë për nxjerrjen e akteve nënligjore që paraqet praktikë të zakonshme legislative.

Më në fund, do të dëshiroja të theksoja, se ky propozimligj promovon një koncept bashkëkohor të sportit, i cili do të mund të jetësohej me një angazhim të shtuar, qoftë të organeve përgjegjëse për sportin, qoftë të bartësve të veprimtarisë së sporteve.

Të nderuar deputetë,

Me shpresë se kam arritur të saktësoj dhe të qartësoj parimet themelore, si dhe qëllimet e synimet e propozimligjit të sportit, ju ftoj që ta mbështetni, si në parim, ashtu edhe në konkretësi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti ministër, ju falemnderit. T'ju përkujtoj se debati për ligjin mund të zhvillohet vetëm në parim. Ju e dini që radha e diskutimit është: kryetarët e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare, anëtarët e Kryesisë dhe deputetët, sipas radhës. Kjo nuk nënkupton paraqitje obligative të secilit.

Më lejoni t'i ftoj, sikur që janë paraqitur. Deputetja Mevlyde Saraçi e ka fjalën.

MEVLYDE SARACI:

I nderuari kryetar, i nderuari zoti ministër dhe ju të nderuar kolegë deputetë,

Ligji i sportit, për të cilin po diskutojmë sot, kuptohet se është i një rëndësie të veçantë. Kosova ka nevojë imediate për këtë ligj, i cili, sot erdhi në shqyrtimin e parë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, materia e të cilit do të rregullon organizimin e zhvillimit të veprimtarive sportive në vendin tonë.

Ky ligj, i përbërë nga 84 nene, përcakton parimet themelore për zhvillimin dhe menaxhimin e sportit në Kosovë nga të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim, dashamirësit e sportit amator dhe sportistët profesional në mënyrë institucionale.

Ky ligj i ka mungaur sportit në Kosovë dhe është një ndër ligjet që do ta ndihmojnë popullatën e Kosovës për organizim më të mirë sportiv, menaxhim dhe avancim të disiplinave sportive.

Jemi të vetëdijshëm se viteve të fundit në Kosovë ka marrë hov edhe privatizimi i sportit, për të cilin, gjer më tani nuk ka pasë mundësi që menaxhimi të rregullohet me ligj.

Prandaj, duhet ta përshëndesim Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve, si dhe Komisionin e përbërë prej profesionistëve, për punën serioze dhe me përkushtim që kanë bërë gjatë hartimit të këtij ligji për sportin.

As ky ligj, nuk pretendojmë se do të jetë i përkryer, por sigurisht se me punën e mëtutjeshme të komisionit përkatës dhe aty-këtu, ndoshta edhe me disa ndërhyrje, do ta marrë dritën e gjelbërt nga ky Kuvend.

Sidoqoftë, vlenë të përmendet se ky ligj në brendi ka elemente të rëndësishme, të cilat do t'i ndihmojnë shumë institucioneve sportive, por edhe individëve dhe më së shumti zhvillimit dhe organizimit më të mirë të të gjitha disiplinave sportive në vend si dhe garantimin e mbështetjes për pjesëmarrje edhe në nivele ndërkombëtare.

Edhe pse në njërin nga nenet është përfshirë edhe përkujdesja nga ana e Ministrisë për sportistët kulmor, megjithatë konsideroj se kjo çështje duhet të precizohet me një nen të veçantë që këta sportistë të fitojnë të drejtën e një pensioni apo të ndonjëloj burse në mënyrë që ata të vazhdojnë të jetojnë të nderuar dhe me status të sportistit kulmor.

Gjithashtu, tek sporti profesionist duhet të precizohet më sakt kush janë ato organizata sportive të cilat quhen profesioniste, në çfarë niveli mund të organizohen garat e këtij lloji dhe po ashtu kujt i përgjigjen të njëjtat. Ndoshta kjo gjë do të ndihmonte në organizimin më të mirë të sporteve dhe do të luftohet gjithësesi dhuna në sport.

Sa i përket Komitetit Olimpik të Kosovës, do të ishte më mirë që ky Komitet të stimulohet në mënyrë që pranimi në nivelin ndërkombëtar të realizohet sa më shpejt.

Ligji duket se i plotëson standardet e nevojshme dhe ju thërras, në emër të Komisionit për kulturë, rini dhe sport, që ta aprovojmë në parim në shqyrtimin e parë, për të vazhduar procedura e rregullt deri në aprovimin e tij.

Ndërkaq, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kërkojmë që të sjellë para deputetëve edhe ligje tjera që i duhen fushëveprimtarisë që zhvillon kjo Ministri, gjithashtu edhe Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë nuk e kuptova, ndoshta në emër të Aleancës, Bujari. Bujar Dugolli, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

BUJAR DUGOLLI:

Të nderuar deputetë,

Është me rëndësi për sportin kosovar që sot para nesh ka ardhë Projektligji për sportin, për t'i dhënë një përkrahje apo një miratim

parimor. Është shumë me rëndësi për ta që ata edhe pas kësaj kohe të gjatë të ndërtimit të institucionit i cili nuk ka pasë një ligj të tillë, më në fund do ta kenë ligjin, metodën se si do ta organizojnë aktivitetin e tyre.

Ne e dimë që sporti në Kosovë është zhvilluar edhe kur nuk ka pasë ministri edhe kur s'ka pasë ligj, thjesht - dëshira e qytetarëve, e njerëzve dhe të rinjve për të kontribuar në këtë aktivitet dhe për t'u plasuar vlerat e veta sportive edhe në arenën ndërkombëtare.

Mendoj që ky ligj është mirë i shkruar dhe i ka ato standardet e parapara ndërkombëtare dhe shqyrtimi në parim lejon që edhe deputetët në aktivitetin e tyre nëpër komisione të japin kontributin e vet dhe kërkojnë që, edhe nga Ministria apo edhe shqyrtimi që do të bëhet nga deputetët, të mos i mundë prap lakmia për të pasë një pushtet, të them, absolut të Ministrisë mbi Komitetin Olimpik që nuk e ka në këtë mënyrë por sidomos mbi federatat sportive, të cilat megjithatë duhet të jenë ato që e rrespektojnë ligjin për veprimtarinë e vet sportive, të mos ketë ndërhyrje nga Qeveria, sepse kështu mund ta pengojnë plasimin e sportit vërtetë edhe në arenën ndërkombëtare.

Normalisht, bashkëpunimi me jashtë i mbetet Qeverisë dhe Ministrisë prap që të punojë, se ky ligj, nuk është një kusht që ia hapë dyert sportit kosovar që të dalë në arenën ndërkombëtare, por duhet të shfrytëzohen edhe metoda tjera që sporti të jetë i pranishëm edhe jashtë. Shpesh kemi thënë që sportistët e vërtetë janë edhe ambasadorë të përfaqësimit të vendit jashtë dhe kjo lëmi tash e sa vjet, domethënë pas lufte, ka ngecë shumë. Njerëzit tanë, sportistët tanë të shkojnë nëpër klube, të përfaqësojnë shtete të ndryshme, të korrin rezultate, të fitojnë medale për shtete të ndryshme, ndërsa nuk kanë mundësi që në emër të Kosovës as ta përfaqësojnë Kosovën dhe as t'i krijojnë sukses në këtë lëmi.

Thjesht, ne, si Grup Parlamentar, mbështesim në mënyrë parimore këtë ligj. Kërkojmë që në procedura të tjera, që do të shqyrtohet edhe në komisionet funksionale dhe të tjera, ta pasurojmë dhe ta fuqizojmë edhe më shumë këtë Projektligj. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Lulzim Zeneli, besoj në emër të Grupit Parlamentar...

LULZIM ZENELI:

I nderuar kryetar i Parlamentit, i nderuar ministër, të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe, si çdo projektligj tjetër, edhe ky ka rëndësinë e vet, padyshim.

Projektligji për sport synon të rregullojë një materie shumë të rëndësishme, siç është sporti dhe përmes këtij Projektligji ofron një kornizë të mjaftueshme për organizimin dhe veprimtarinë sportive, por edhe për zhvillimin e tij në Kosovë.

Përmes këtij Projektligji synohet të arrihet një menaxhim më i suksesshëm dhe një avancim më i mirë, si edhe ka ndodhur deri më tash në sportin në Kosovë, por gjithësesi të arrihet në segmentin e ndërkombtarizimit të tij në arenën ndërkombëtare.

Lidhja Demokratike e Kosovës përkrahë në parim këtë Projektligj, me shpresë që në fazat e mëvonshme, përmes amendamenteve, të përmirësohet, të korrigjohet. Edhe pse është një Projektligj që, në krahasim me shumë projektligje tjera, ka një avantazh, mirëpo duke pasë parasysh se edhe në këtë Projektligj ka çka të përmirësohet dhe të korrigjohet, sidomos në harmonizimin e kapitujve, në përmbajtjen sa i përket brendisë së këtij Projektligji.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës përkrahë në parim dhe fton deputetët ta përkrahin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Lubomir Stanojković, në emër të Koalicionit “Kthimi”.

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Poštovani predsedniče, dame i gospodo, poštovane kolege,

Ovoga puta se obraćam pre svega kao jedan bivši sportista, kao čovek koji je član Funkcionalne komisije i kao predstavnik Koalicije «Povratak».

Kao čovek, koji se nekada bavio sportom i pripadnik ove Funkcionalne komisije, moram da priznam da ovakav zakon podržavam iz prostog razloga s obzirom da imam prilike preko televizije da posmatram mnoge sportske događaje koje se na Kosovu dešavaju, jer ima previše nesportskog ponašanja i incidenata. Ako ovaj zakon, na neki način pokušava da ovu oblast reguliše koliko-toliko da bi se ti incidenti, ta nesportska ponašanja smanjila, stvarno, iz tih razloga, podržavam ovaj zakon.

Kao čovek koji je pripadnik Srpske nacionalne zajednice, kao čovek koji predstavlja Koaliciju «Povratak», moram ovde, svima vama, da iznesem, verovatno je i svima vama poznato, ali to je zapravo oblast, to je zapravo oblast gde nijedan javni sportski objekat ili institucija u ovom momentu, u ovom momentu nijednom Srbinu, odnosno sportisti, a da je Srbin nije, nije dostupno. Ako ovaj zakon, na bilo koji način, barem pokuša da omogući da se to nešto desi, onda opet pozdravljam.

Moramo da priznamo da je ova oblast, ne samo ova, ali jedna od oblasti, malo i mnogo više, možda smo svi mi čitali i slušali da je to, gospodine Dugoli – bilo u Južnoj Africi, ali izgleda, osim u Južnoj Africi - i na Kosovu je prisutno. Medjutim, razlog zbog čega u ovom momentu..., razlog zbog čega u ovom momentu, kao Koalicija «Povratak»..., kao Koalicija «Povratak» nećemo da podržimo i bićemo uzdržani, to je činjenica da je, kao u većini zakona, i u ovom zakonu ima elemenata državnosti. Znači, nijedan zakon pa ni ovaj ne boluje od elemenata

državnosti i ima onoga zatvaranja! Vi znate ipak da svi mi ovde, koji malo volimo sport, više volimo da gledamo ligu šampiona u fudbalu, nego nacionalna prvenstva!? Zato, mislim da sport ne bi trebali previše da zatvaramo i uokvirujemo.

Iz tih razloga, Koalicija «Povratak» u ovom momentu će biti uzdržana, ali ako kroz amandmane uspemo da nešto popravimo, onda ćemo ga podržati. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Sabit Rrustemi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, ministra dhe të pranishëm tjerë,

Natyrisht, duke përkrahur shqyrtimin e parë të Projektligjit të sportit, të përcaktuar në këtë procedurë kuvendore, vlerësoj vlerën e sportit në tërësi dhe angazhimin e sportistëve dhe të të gjithë atyre që merren me këtë veprimtari të rëndësishme të sportit. Është një bazë e mirë juridike për rregullimin e veprimtarive të sportit dhe përgjegjësive në sport dhe në veçanti duke i përcaktuar të drejtat dhe detyrat e organizatave sportive, si dhe të Komitetit Olimpik të Kosovës.

Megjithkëtë, ky propozimligj karakterizohet me këto cilësi.

E para, pajtueshmëria e plotë me standardet ndërkombëtare të sportit.

E dyta, ngritë përgjegjësinë në sferën e sportit në Kosovë.

Dhe, e treta – por nuk japë zgjidhje të mjaftueshme për eliminimin e dhunës dhe të dukurive negative në sportin e Kosovës.

Mendoj se në këtë ligj, nuk është dashur të theksohet një fjali aty, “është shtypur në mënyrë elektronike” sepse nënkuptohet format...

Për dallim nga ligjet e mëparshme, ky ligj veçohet me begatimin gjuhësisht dhe më mirë i formuluar juridikisht, dispozitat e thukta dhe të qarta, si dhe është shumë e vërtetë, i barazon të gjithë qytetarët pa dallim kombëtare apo përkatësive etnike, me mundësinë e barabart të zhvillimit të aktivitetit sportiv në Kosovë, gjë që e demanton atë që u tha pak më parë.

Ky propozimligj proklamon dhe mbronë interesat publike të veprimtarisë sportive në Kosovë, nën mbështetjen e institucioneve të saj. Unë mendoj se duhet të mbrohet edhe interesi kombëtar i sportit dhe duhet të inkorporohet në këtë pjesë, në fazën e dytë.

Ndonëse propozimligji është i sistemuar mirë nga këndi i përgjithshëm juridik, është dashur të numërohen edhe degët e sportit në Kosovë dhe mënyrat e financimit të këtyre degëve në aktivitetin e tyre.

Propozimligji nuk përcakton formën e organizimit funksional dhe qeverisës të Komitetit Olimpik të Kosovës, federatës sportive, klubit të sporteve. Këto tri organizata nuk duhet të punojnë mbi baza amatore, siç përcaktohet dhe jipet, por duhet të punojnë mbi parimin e profesionalizmit.

Dhe, po e përfundoj, mendoj se pasi që ligji parasheh pjesëmarrjen e sportistëve të Kosovës jashtë Kosovës, do të ishte e dëshirueshme por edhe e obligueshme që të kemi simbolet unike kombëtare dhe amblemet e tyre të përcaktuara me këtë ligj për pjesëmarrje në garat sportive.

Edhe një herë përsëris: vlerësoj se këto vërejtje do ta begatojnë këtë ligj dhe përkrah mendimin e grupeve parlamentare që të aprovohet në fazën e parë dhe të miratohet si i tillë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit. Sabit, ju lutem një moment. Unë po bie gjithmonë në pozitë që të mos mbaj rendin. Unë do të lutja që herave tjera të rrespektohet vendimi që të paraqiten te shërbimi përkatës ata që paraqiten, për ta ruajtur rendin si duhet. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK, do të thotë sipas rregullores, Hajredin Kuqi.

HAJREDIN KUQI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Do të provoj që t'i përmbahem në tërësi asaj çka paraqet parimi apo shqyrtimi i parë i këtij Projektligji për sport.

Në radhë të parë, mendoj se Projektligji për sport mund të hyjë në kuadër të prioriteteve të Kuvendit për shqyrtimin e ligjeve. Po ashtu, mendoj se kjo fushë ka nevojë që të rregullohet në shoqërinë e Kosovës, e cila do të rregullojë apo do të krijojë mundësi më shumë për sportin dhe sportistët. Njëkohësisht, kam bindjen që buxheti i Kuvendit, apo buxheti i Qeverisë së Kosovës ka mundësi që ta përballojë aprovimin e këtij Projektligji dhe njëkohësisht Grupi Parlamentar i PDK mendon se ky Projektligj është në përputhje të plotë me Kornizën kushtetuese të Kosovës. Po ashtu, mendojmë se nuk i prekë apo nuk i cenon të drejtat e komuniteteve.

Në fund, mund të them se Projektligji është në përputhje edhe me të drejtën ndërkombëtare apo me normat dhe dispozitat ndërkombëtare që krëkohen për këtë rast dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrahë në parim.

Vërejtje dhe sygjerime tjera, me siguri, do të japim gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Sabit Rrustemi e ka fjalën.

SABIT RRUSTEMI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, i nderuar ministër,

Dola këtu jo pse i përkas veprimtarisë sportive, por si dashamirë i sportit dhe i Komisionit funksional që edhe ka të bëjë me këtë ligj, që ta përshëndes Projekligjin e tretë që vjen nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Çështje Rezidence, si një ndër propozimligjet më të përkryera që deri tash janë sjellë në Kuvendin e Kosovës. Edhe diskutimet e deritashme e vërtetuan këtë që po e them me këtë ligj. Dhe, aspak nuk më pengon ajo ana e elementeve shtetërore që i ka ky ligj, por përkundrazi, ka nevojë t'i shtohen edhe pak më tepër.

Në parim, ligji është i pranueshëm dhe është i përkryer.

Disa çështje që do të duhej të thuheshin dhe që i kam veçuar në këtë diskutim të parë, janë këto:

Te çështja e kategorizimit, që përmendet në propozimligj. Jo që do të mund të autorizohej, por Ministria e ka për obligim të autorizojë një trup profesional dhe ta bëjë kategorizimin e sportistëve.

Pastaj te raporti me federatat. Mendoj se ka nevojë më shumë që të nxiten dhe të stimulohen federatat, pavarësisht se janë joqeveritare, edhe përmes këtij ligji, kur dihet se tërë veprimtaria sportive zhvillohet përmes tyre. Prandaj, duke i bartur disa zyrtarë regjional që i ka ministria nëpër komuna do të kishte mund t'i stimulojë më tepër federatat për ta nxitur veprimtarinë sportive.

Edhe çështja e stimulimit të sportistëve kulminant që përmendet në ligj. Nuk do të duhej vetëm të kujdesemi ndaj tyre, por do të duhej ta kemi një përkushtim më të madh në aspektin profesional individual të tyre. Çka më tutje, pas përfundimit të karrierës së tyre? Ne kemi mjaft futbollistë, mjaft

sportistë të tillë që kanë shënuar rezultate garash në të kaluarën dhe sot, në një mënyrë, i kemi lënë në harresë. Por, harresa më e madhe këtu ka të bëjë me ngritjen e tyre intelektuale që do të duhej të precizohej edhe me këtë ligj pak në mënyrë më specifike.

Është edhe një çështje që kujtoj ligji do të duhej ta ketë më tepër në konsideratë: çështjen e shfrytëzimit apo menaxhimit me objekte sportive. Këtu përmenden, mirëpo nëse iu lëhen vetëm me: “organeve përgjegjëse”, e nuk thuhet cilat janë ato organe, shpesh mund të manipulohet në emër të organeve përgjegjëse, sidomos tash kur kemi të bëjmë me privatizimin dhe me AKM - mund të ketë manipulime të tilla, të cilat përmes ligjit do të duhej të stopohen.

Është edhe çështja e reklamave dhe sponsoruesve e që përmenden në ligj dhe mendoj se edhe këto ka mundësi të definohen pak më shumë se çka i takon sponsoruesit e çka reklamuesit. Ne jemi dëshmitarë se në të shumtën e rasteve në Kosovë, sponsoruesit në një mënyrë janë edhe patronë të klubeve.

Këtu thuhet “klubet publike dhe klubet private”. Megjithatë do të duhej të hiqet një vijë e qartë – cilat konsiderohen klube publike në Kosovë, gjithnjë nga aspekti sportiv.

Pastaj te çështja e marrëdhënieve me jashtë – te federatat. Kujtoj, Ministria duhet ta ketë një rol më të madh në bashkëpunim me federatat.

Edhe te mbrojtja shëndetësore e sportistëve. Çka të bëhet më vonë, pas lëndimeve të sportistëve nëpër gara të ndryshme sportive. Kush do të duhej të përkujdeset për ta? Mendoj që edhe këtu ka mundësi të bëhet diçka më shumë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Ivanoviq, le të bëhet gati Gani Koci.

OLIVER IVANOVIĆ:

Poštovane kolege,

Ovo je, moram da kažem, jedna od retkih tema s kojim se... o kojoj se može govoriti potpuno relaksirano i ja lično bih mogao pričati o ovoj temi čitav dan i noć. To je jednostavno tema koja je meni omiljena.

Mislim da postoji potreba da se ova oblast uredi zakonom i to je nedvosmisleno, to otprilike govore svi oni koji su do ovog trenutka govorili. Mislim da je jako važno da se kroz usvajanje ovog zakona stvore uslovi za bavljanje sportom mladih ljudi jer čini mi se da nam je to uzrasna kategorija o kojoj se redovno vodi računa, a kao direktnu poslednicu toga, imate porast droge, korišćenja droge, alkoholizma i pušenja, što do sada ne vidimo kao veliku opasnost, ali ja mislim da to je izuzetno velika opasnost a konsvekvence jednoga, rekao bih, jedne tolerancije takvih noviteta u našoj pokrajini, mislim da ćemo videti za pet, šest ili deset godina. To ćemo videti svi, kao čitavo društvo.

Ja bih rekao da je zakon nedvosmisleno dotakao ono što je važno, to je kvalitetni sport i pitanje uređenja rada klubova, njihovo finansiranje i njihovo ponašanje, znači obaveze prema društvu i zajednice. Ono što mislim da bi moglo malo preciznije da bude definisano to je pitanje masovnog sporta ili, kako smo mi imali običaj da zovemo to – školski sport i škole sportova. To je ono što bi možda trebalo da bude forma - fokus naš.

Velike ambicije, velike reči i pokušaj da se kroz ovaj zakon, takodje unesu nekakvi državni elementi, nisu... nije dobro rešenje. Mislim da se stvaraju nerealne ambicije koje mi nećemo moći da pratimo kao zajednica ovde. Svedoci ste, da smo malopre usvojili Zakon o pesticidima jednoglasno, i nekoliko zakona svega usvojeno na taj način i ja vas molim da kroz amandmane i kroz proceduru probamo da ovaj zakon popravimo u meri da eliminišemo te političke implikacije, jer politizacija sporta nije nešto što je dobro. To je možda jedina, rekao bih, društvena delatnost koja nas može da približi. Ne bi trebalo da izgubimo tu šansu i čini mi se da amandmani mogu u tom smislu da koriguju ovaj zakon do mere da bude

prihvatljiv i za Koaliciju «Povratak» i mi bi smo sigurno u tom slučaju glasali za taj zakon. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Sporti është një nga veprimtaritë ku më së paku do të duhej të gjendte vend politika dhe ne si popull i Kosovës e dijmë më së miri se ç'është segregacioni dhe ç'është apartheidit edhe në fushën e sportit, sepse kemi përjetuar një periudhë të cilën e dijmë të gjithë dhe s'ka nevojë të elaborohet. Shtetit të Kosovës i duhet një ligj siç është ligji për sportet dhe unë e konsideroj se është një bazë e mirë që edhe kjo fushë e veprimit shoqëror të ecë rrugës së vet dhe të ecë binarëve të vetë.

Unë e konsideroj, kur thash se sportit më së paku i duhet politika, por sportit gjithashtu i duhen më së paku edhe ndërhyrjet administrative. Sepse, pikërisht ndërhyrjet administrative, qofshin ato të Ministrisë, qofshin të Qeverisë - ato mund të dëmtojnë më së shumti sportin. Këtu e kam fjalën... Nuk ka asnjë trup profesional që mund të bëjë kategorizimin e sportistëve përpos vetë rezultatet dhe sukseset e sportistit dhe në moment kur trupi profesional, do të thotë, caktohet që të bëjë kategorizimin e sportistëve, menjëherë vjen këtu në shprehje edhe ana subjektive. Prandaj, kriter për përcaktimin ose kategorizimin e sportistëve janë rezultatet që ata i arrijnë.

Ajo që u tha këtu edhe nga disa parafolës për përfshirjen edhe të njerëzve, pa dallim feje, pa dallim grupesh etnike, e tjera, e tjera, mua më duket vetëm në qoftë se shikojmë ndeshjet tona sportive, sidomos në fushën e basketit, atje kemi mjaft emra që, për mos me thënë janë emra dominant në këtë sport, nuk janë shqiptarë. Dhe, kjo do të thotë se edhe sporti, edhe veprimtaria sportive në Kosovë, është e hapur dhe duhet të jetë dhe do të

jetë e hapur për të gjithë ata që tregojnë rezultate dhe tregojnë interes që të zhvillojnë këtë fushë.

Unë dua të përmendi se, megjithatë ky ligj përmban disa përsëritje që konsideroj nuk janë të nevojshme. Shikoni vetëm nenin 2 dhe nenin 5 që e njëjta gjë është që thuhet dhe një çështje tjetër që dua ta them, është se në pjesën ku përshkruhen ndëshkimet në thyerjen e rregullave sportive. Ju e dini se fushat tona të sportit, sidomos në futboll, janë bërë arena të përleshjeve. Në këtë drejtim, konsideroj se këtu më shumë do të duhej të ndërhyjmë administrativisht, në mënyrë që të ndalohet ky fenomen që e dëmton sportin në veçanti dhe e dëmton edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Konsideroj se ky ligj, ose ky Projektligj, edhe në plotësimin me amendamente të ndryshme do të përmbushë edhe këtë fushë të jetës sonë shoqërore. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Nuk ka të paraqitur tjerë. Unë ju ftoj që të votojmë për aprovim në parim të Projektligjit.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Trembëdhjetë abstenime.

Prandaj, konsideroj se Ligji është aprovuar në parim dhe i drejtohet komisioneve përkatëse për shqyrtim të mëtejshëm. Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against02...
 - Abstenime – Uzdrzanih – Abstained....13...
-

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës. Pika e katërtë është:

- Shqyrtimi i propozimit të panelit lidhur me kundërshtimin e Koalicionit “Kthimi” në Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

T'ju informoj për konstatimet hyrëse. Ligji për qasje në dokumente zyrtare është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 26 qershor të këtij viti. Koalicioni «Kthimi» ka parashtruar kundërshtim për të sfiduar disa dispozita të këtij Ligji mbi baza të dyshimit të cenimit të të drejtave dhe interesave të komunitetit.

Në pajtim me rregullat e procedurave sipas Kornizës kushtetuese dhe Rregullores së punës, paneli i posaçëm ka marrë vendim me të cilin i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare, me ndryshimet sipas tekstit të propozuar.

Vendimi i panelit dhe materialet tjera iu janë shpërndarë me kohë deputetëve.

Sipas kreut 9.1 të Kornizës kushtetuese, Kuvendi vendosë. Unë do të doja të di mendimin e Komisionit për legjislacin dhe kornizë kushtetuese, nëse ka diçka dhe nuk është i obligueshëm. Në qoftë se nuk ka, atëherë duhet.... Hydajet Hyseni dëshiron fjalën. Urdhëro Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Zonja dhe zotërinj deputetë, zoti kryetar,

Ne po shqyrtojmë sot, më sakt, rekomandimin e Komisionit të panelit në përputhje me Kornizën kushtetuese dhe dispozitat tjera të Rregullores sonë. Është një çështje sa e ndieshme aq edhe një praktikë e veçantë parlamentare. Ne po zhvillojmë një praktikë shumë të veçantë parlamentare të ndryshimit të ligjeve të aprovuara tashmë, në njëfarë mënyre për deriçke. Kjo është mundësuar me Kornizën kushtetuese dhe është për ta diskutuar por unë nuk dua të ndalem kësaj radhe sa është në rregull që kjo të mundësohet vetëm për një segment specifik – vetëm për komunitetet etnike dhe jo, ta zëmë, për komunitetet tjera. Mirëpo, në

përputhje me shkronjën e Kornizës, është paraparë një mundësi e tillë që, në rastet, kur shprehimisht thuhet: – shkilen të drejtat e komunitetit ose të anëtarëve të tij, që cenojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe shprehjen e identitetit etnik, kulturor, fetar ose gjuhësor – mund të procedohet në këtë mënyrë. Por, është kërkuar shprehimisht që të ketë një shpjegim të arsyetuar, do të thotë të argumentuar me fakte se ndodhë pikërisht kjo që sanksionohet.

Kurse, në Ligjin që ne po e shqyrtojmë dhe në propozimin, ose rekomandimin e panelit, mund eventualisht të flasim se, ose mund ta marrim parasysh rekomandimin në amendamentin e parë – nenin 3, në të cilin, është e vërtetë se një pjesë e qytetarëve të Kosovës, për arsye që edhe shpjegohen këtu, mund të jenë të tanguar në realizimin e një drejte elementare.

Prandaj, si edhe çdoherë, kur vërtetë është fjala për të drejtat e cilitdo komunitet, unë dhe jam i bindur i gjithë ky Kuvend jemi në favor të zgjidhjeve që mundësojnë realizimin e të drejtave të tyre elementare. Por unë dua të theksoj se edhe në nenin 3, në të vërtetë jo më pak janë penguar qytetarët e kombësisë shqiptare për të realizuar të drejtat e tyre. Madje, me propozimin që është dhënë këtu, thotë – që të jetë kriter e drejta e tyre ose mundësia e tyre për të qenë të regjistruar, me praktikën që po zhvillohen tani, janë pikërisht shumica shqiptare që diskriminohet. Por, megjithatë kjo nuk është çështje tani e shqyrtimit të saj dhe unë vetëm po dua të tërheq vërejtjen në të. Kështu që do ta mbështesim nenin 3 edhe kështu siç është propozuar, megjithë vërejtjet që duhet t'i theksoj.

Mirëpo, lidhur me propozimet tjera – nenin 4 dhe nenin 4.2, dua të tërheq vërejtjen se në të vërtetë këtu dalin jashtë materies së paraparë me dispozitat në të cilat po thirremi. Vëni re, ju lutem! Me nenin 4, ndryshohet në pjesën e parë – «refuzon ose nuk lejon», kurse në pjesën e fundit, në pikën b) në gjuhën shqipe është ndryshuar teksti «që është dëmtuar» dhe s'ka të bëjë absolutisht asgjë me mbrojtjen e të drejtave të cilitdo komunitet. Në gjuhën shqipe është thënë, do të thotë «në raste që»... mos ta përsëris më shumë, lidhur me «privatësinë» - ju e dini sa është shqipe kjo dhe «ndershmërinë» si zëvendësim i shprehjes që ishte në versionin e mëparshëm «të integritetit të individit» shprehje e cila është edhe në tekstin anglisht edhe në tekstin serbisht. Shprehja »ndershmërinë»

nuk e mbulon kuptimin që ka «integritetit të invidit». Kurse, sido që të jetë, nuk ka të bëjë fare me të drejtat e komuniteteve.

Dhe, për fund, është propozuar një nen i ri. Unë nuk jam i bindur se në këtë fazë ne mund të lejojmë praktika të tilla që të propozohen nene të reja, sepse lejojmë një preseden shumë problematik, me të cilin thuhet shprehimisht «qasja dhe klasifikimi i dokumenteve lidhur» - vëni re, ju lutem «me çështjet e rezervuara, duke përfshirë sigurinë, mbrojtjen dhe çështjet ushtarake, marrëdhëniet e jashtme dhe politikën monetare brenda fushës së përgjegjësisë së PSPP ose tjera». Do të thotë, dy herë përsëritet fusha e rezervuar, kurse me këtë pjesë të parë ajo totalizohet në njëfarë mënyre dhe do të thotë marrëdhëniet e jashtme, siguria interpretohen si ekskluzive për institucionet e Kosovës dhe është interpretim prapavajtes në krahasim deri edhe me Kornizën, edhe ashtu siç është.

Prandaj, unë propozoj që pjesa e parë «në çështjet e rezervuara» të fshihet dhe të mbetet «në çështjet e sigurisë» dhe tjera në fushën nën përgjegjësinë e PSPP që do të ishte konform edhe shkronjës së Kornizës.

Për ta përmbyllur këtë që them, unë propozoj që të mbëstesim nenin 3. Të mos i japim përkrahje nenit 4, sepse nuk ka të bëjë me këtë dhe është, sidomos në versionin shqip që dëmton tekstin dhe prishë atë dhe ta korrigjojmë nenin 4.2 me fshirjen e formulimit në çështjet e rezervuara dhe të mbetet pastaj si vijon: çështjet e sigurisë e tjera në nën përgjegjësinë e Përfaqësuesit Special, e tjera. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Zoti Dugolli, e ka fjalën.

BUJAR DUGOLLI:

Ju falemnderit. Më kujtohet se këtë Ligj ne e kemi diskutue, kemi bërë edhe debat publik, kami marrë mendimin e ekspertëve profesionist për këtë dhe mesa jemi të njoftuar ne edhe si Grup Parlamentar, por edhe si Komision për shërbime publike, Koalicioni «Kthimi» nuk iu ka

përmbajtur afatit kohor për të paraqitur vërejtjet e tyre dhe më s'di se si janë marrë këto vërejtje dhe janë futur në procedurë kur nuk ka bazë ligjore. Një.

Dhe, e dyta. Ne e dijmë që atëherë ka pasë një ngatërresë në mes Komisionit dhe vetë deputetit Sejdiu sa i përket nenit 3.1, por më vonë e kemi sqaruar se prapë neni 3.1 siç është propozuar nga Komisioni i Shërbimeve publike është dashur të votohet nga Kuvendi. Por megjithatë ka ndodhur ky lëshim dhe unë mendoj se këtë nenin 3.1 mund ta pranojmë kështu siç është propozuar, edhe pse janë bërë ato shkelje procedurale, mund ta kalojmë dhe ligji të hyn në fuqi.

Ndërsa, neni 4.1 dhe 4.2. nuk kanë kurrfarë baze. Ne e dijmë çka janë çështjet e rezervuara dhe e dijmë se ato çështje të rezervuara... ne nuk po kemi qasje as si institucione e lere më të kanë qasje qytetarët apo mediumet publike. Ne dijmë se në Kosovë është në interes publik mbrojtja dhe çështja ushtarake. Ne e dijmë se në Kosovë ka ushtri, ka ushtri të NATO-s, trupat e KFOR-it dhe e dijmë se kjo çështje është e rezervuar për dikend dhe ne nuk mund ta heqim nga ligji këtë çështje, këtë figurim që është. Po, kjo nënkuptohet se është një pjesë e rezervuar, por normalisht nuk do të mbetet gjithë e rezervuar, as politika e jashtme, as politika financiare, monetare, ekonomike e tjera.

Dhe, unë mendoj se, përveç nenit 3.1. që mund ta përkrahim, 4.1. dhe 4.2. nuk ka nevojë të përkrahen se dëmtohet esenca e Ligjit sepse këto përkohësisht janë pjesë të rezervuara, ndërkohë do të transferohen dhe ne jemi duke bërë kërkesë që të transferohen këto përgjegjësi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë mendoj se mund ta rumbullakësojmë, sepse kemi mendimet ... Urdhëroni zoti Kurteshi, por i kemi të kristalizuara çështjet... Më fal Sabri, ia dhash fjalën.

ISMAJL KURTESHI:

Unë desha vetëm të them se ky Ligj është shqyrtuar në Komitetin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe atje ky Komitet ka konstatuar se Ligji nuk i cenon të drejtat e interesave të komuniteteve edhe pse kjo çështje është ngritur nga përfaqësuesit e «Kthimit» dhe mendoj se Kuvendi duhet ta ketë parasysh edhe shqyrtimin e këtij Komiteti, i cili ka bërë një punë serioze. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Ne kemi studiuar këtë kundërshtim dhe këtë mendim të panelit, i cili këtu vjen me një përfundim interesant, thotë «me koncensus» teksti poshtë. Mirëpo, mendojmë se nuk është i plotë referimi i panelit për shkak se ne nuk dijmë... Unë për veti kam informata nga Komisioni gjegjës që ushtrimi i kundërshtimit nuk është bërë me afat dhe referencë të tillë në këtë raport të panelit nuk kemi. Kjo është shumë esenciale për këtë problem dhe unë kërkoj që të artikulohet mirë kjo punë. Nëse nuk është bërë me afat, unë mendoj se s'mund të shqyrtohet hiq. Nën një.

Nën dy. Atëherë, nëse janë plotësuar këto kushte, dhe kemi të dhëna se ka ndodhur ky kundërshtim në bazë të afatit të ligjit, edhe të asaj Kornize nën të cilën punojmë, eventualisht mund të diskutojmë a do të shkojmë prej nenit në nen apo s'do të shkojmë prej nenit në nen, dhe ajo është punë tjetër. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Vetëm një sqarim. Në Kryesi Kryesia i ka pranuar realitetet e paraqitjes së kundërshtimit dhe ka vendosë në rend të ditës.

Procedura ka përfunduar deri këtu, prandaj duhet të vendosim... Liljana Keniq e ka fjalën, dhe do të marrim një vendim si seancë plenare.

LILJANA KENIĆ:

Poštovani poslanici,

Povodom preporuke panela, mišljenja smo da preporuke panela predstavljaju svakako bolje rešenje u odnosu na rešenja koja su bile data u Zakonu o uvidu službenih dokumenata. Vama je poznato da u panelu bilo bi povoljno da se odluke donose konsenzusom. Odluke nisu donete konsenzusom po pitanju od dve ili tri tačke.

Oko spornog člana 3.1. jesmo u principu zadovoljni sa datim rešenjem, ali mislimo obzirom da nije prihvaćen naš predlog, da se član 3.2. briše. Smatramo da i dalje postoji to delimično ograničenje po pitanju pristupa svim licima na uvidu dokumenta i smatramo da nije ispoštovana preporuka Evropske komisije o pristupu službenim dokumentima po tom pitanju. Članom 4.2. koji je kao novi član predložen od strane panela jesmo zadovoljni i smatramo da je neophodno da taj član 4.2. postoji. Članom 4.1. u principu jesmo... mislimo da je mnogo bolje rešenje u odnosu na prethodni predlog zakona. Međutim, sporna je tačka 4.1 a) podtačka i), primena izraza «javna sigurnost» odnosno koja u toj tački ne predstavlja..., u toj tački ne predstavlja rezervisano pravo, a u tački 4.2. predstavlja rezervisano pravo. Želim da istaknem da izraz «javna sigurnost» odnosno «javna bezbednost» jesu isti..., potpuni isti izraz. To je..., imaju potpuno isto značenje, samo što je izraz «javna sigurnost» hrvatski izraz i tu je absurd te tačke.

Zbog toga, smatram da zbog prethodno navedenih razloga, ove preporuke delom nisu prihvatljive za Koaliciju «Povratak».

Ako ova Skupština usvoji ove preporuke, ostaje na UMNIK-u odnosno SPGS da proceni da li će objaviti ovaj zakon ili će predložiti izmene u ovom delu u kojem sam ja istakla, što bi, mislim, po našem... bilo najlogičnije i najpravičnije rešenje. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë mendoj se mund të vendosim. Unë ju lus për vëmendje.

Nën një. Në propozimin e parë, nenin 3, nuk ka asnjë kundërshtim të të gjitha grupeve parlamentare. Prandaj, në nenet tjera ka kundërshtim të gjitha grupeve parlamentare. Prandaj, propozoj që të aprovohet propozimi i panelit – të nenit 3, atë që e tha zoti Hyseni, ndërsa për këto të tjerat të vendosim pastaj.

Kush është për atë që jemi unik të gjithë për nenin 3 të propozuar sipas panelit. Ju falemnderit shumë.

A ka ndonjë votë kundër? Dy vota kundër.
A ka abstënime për këtë? Dy vota abstënime.

Prandaj, konsideroj se neni 3 aprovohet i propozuar nga paneli.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against.....02.....
 - Abstënime – Uzdrzanih – Abstained..02.....
-

Për nenet tjera, nuk ka qasje unike por unë do të pyes – kush është për nenin 4.1 me radhë. Për nenin 4 në përgjithësi.

Domethënë, kush është për propozim të panelit për nenin 4. Nuk është askush, prandaj s'kam çka ta vë

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For00.....
-

Ju lutem, mos u mundoni me më mësuar, ju kam thënë. Mos u mundoni me më mësuar. Për mësimë askush, deri sa të jam në mandat. Ju falemnderit. Do të thotë askush nuk është për atë propozim.

Dhe, na ka mbetë 4.2. Prap nuk ka qasje unike.

Kush është për pranimin e këtij neni të propozuar, kështu nga paneli? Numëroni votat “për”. Tetë vota për. Nuk ka vendim për dhe nuk aprovohet.

Shtatëmbëdhjetë vota janë për. Mirë de, unë lus shërbimin gjithmonë ta kryejë punën mirë, por paraqituni me kohë në votim, e jo të vonoheni, të mendojnë e të konsultohen për apo ...

Shtatëmbëdhjetë vota janë “për”, prandaj janë vota të pamjaftueshme për ta aprovuar dhe nuk ka nevojë për procedurë të mëtejme...

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For..... 17.....

Ju falemnderit për pjesëmarrje në punën e seancës plenare.

Nuk kemi tjetër çështje për shqyrtim. Shihemi në të enjten e ardhshme, në seancë plenare.

Seanca përfundoi punën në orën 11,30.

E transkriptoi (fq.1-35) RT, Zyra E04, tel.211-860